

Parathënie

Agjencioni i Statistikës së Kosovës (ASK) përkatësisht Departamenti i Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit ka filluar grumbullimin e të dhënave për çmimet e inputeve bujqësore në nëntor të vitit 2003. Në fillim, çmimet grumbulloheshin për një numër të kufizuar të artikujve, me ndërrimin e vitit bazik nga 2005=100 në 2010=100 është rrit edhe numri i inputeve. Aktualisht grumbullohen çmimet për 77 inpute të ndryshme bujqësore

Ndërrimi i vitit bazik Indeksi i çmimeve të inputeve dhe çmimet në bujqësi është bërë në bazë të rekomandimeve të Eurostatit, duke u bazuar te: Udhëzuesi i BE-së për Statistikat e Çmimeve Bujqësore versioni 2.0 Mars 2008 viti bazik 2005=100 në vitin bazik 2010=100, ku ndërrimi i vitit bazik rekomandohet çdo pesë vite .

Ky është publikimi i tridhjetë e tretë mbi Indeksit e çmimeve të inputeve dhe Çmimet mesatare absolute të inputeve bujqësore përgatitur nga Agjencioni i Statistikës së Kosovës Në këtë publikim, janë paraqitur Indeksi i çmimeve të inputeve dhe çmimet për disa inpute kryesore bujqësore.

ASK falënderon Agjencinë Suedeze për Zhvillim dhe Kooperim Ndërkombëtar (SIDA) për mbështetjen e tyre për ndërtimin e sistemit të statistikave agromonetare. ASK gjithashtu falënderon për bashkëpunim të gjithë bashkëpunëtorët e zyrave rajonale të ASK, respondentët për ofrimin e të dhënave: fermat bujqësore, ndërmarrjet industriale dhe tregtare, etj.

Falënderojmë në veçanti ekspertët Suedez të statistikave të çmimeve, Z. Anders Grönvall, Z. Jimmie Enhall dhe të tjerët që në mënyrë të drejtpërdrejt apo indirekt ndihmuan në finalizimin e këtij publikimi.

Komentet, propozimet dhe sugjerimet tuaja janë të mirëseardhura dhe ato mund të drejtohen në adresën elektronike: E- mail: agriculture@ks-gov.net

Publikimin e përgatitën:

Bajrush Qevani – Drejtor i departamentit,

Violeta Arifi – Gashi – Shefe e divizionit,

Kademsha Bajramaga – Zyrtare

Nëntor 2017, Prishtinë

Kryeshef Ekzekutiv i ASK

Isa Krasniqi

Lista e shkurtesave dhe simboleve

ASK	-	Agjencioni i Statistikës së Kosovës
IÇIIB	-	Indeksi i Çmimeve të Inputeve në Bujqësi
BE	-	Bashkësia Evropiane
SIDA	-	Agjencioni Ndërkombëtarë i Suedisë për Zhvillim dhe Kooperim
TM3	-	Tremujori i tretë
%	-	Promil

Në tabelat ku janë dhënë peshat numrat janë rrumbullakuar deri në shifrën e fundit më të afërt për këtë arsye mund të ketë një mospërputhje të lehtë të shumave.

P ë r m b a j t j a

Indeksi i çmimeve të inputeve bujqësore.....	4
Indeksi i çmimeve të inputeve bujqësore TM3 2010-2017 (2010=100).....	5
Indeksi mujor i çmimeve të inputeve bujqësore korrik – shtator 2017, (2010=100)	6
Tabela 2: Indeksi mujor i çmimeve të inputeve bujqësore korrik – shtator 2017 , (2010 = 100).....	6
Ndryshimi mujor i indeksit të çmimeve të inputeve bujqësore korrik – shtator 2017/2016 (2010=100)	7
Metodologjia	8
Pyetëtori.....	9

Indeksi i çmimeve të inputeve bujqësore

Publikimi përfshin të dhëna për periudhën korrik - shtator 2017 (TM3 - 2017). Publikimi bazohet në çmimet e inputeve bujqësore të grumbulluara në Kosovë. Grumbullimi i çmimeve është kryer në barnatoret bujqësore, barnatoret veterinarë, në kompani, tregje dhe vende tjera ku çmimet e inputeve bujqësore janë në dispozicion. Disa çmime të inputeve bujqësore janë marrë nga çmimet e konsumit (CPI) nga ASK.


Produktet të cilat e përbëjnë bazën për Indeksin e çmimit të inputeve janë të ndara në dy grupe kryesore: Mallrat dhe shërbimet aktualisht të konsumuara në bujqësi (Input 1) dhe Mallrat dhe shërbimet që kontribuojnë në investimet në bujqësi (Input 2). Brenda grupit të Mallrave dhe shërbimeve aktualisht të konsumuara në bujqësi, çmimet grumbullohen sipas grupeve në vijim: farëra dhe material mbëltues, energji; vajra, plehra dhe përmirësues të tokës, produkte për mbrojtjen e bimëve dhe pesticide, shpenzime për veterinarin, lëndë për ushqimin e kafshëve, mirëmbajtja e materialeve, mirëmbajtja e ndërtesave, si dhe mallra dhe shërbime tjera. Sa i përket mallrave dhe shërbimeve që kontribuojnë në investimet bujqësore, çmimet grumbullohen për materiale (makineri dhe pajisje tjera), ndërtesat (ndërtesat të fermës, punët tjera përveç përmirësimit të tokës, ndërtesat tjera, struktura e tyre) dhe të tjera.

Grafiku 1 tregon Indeksin e tremujorit të tretë të çmimeve të inputeve nga 2010 – 2017 për Inputet në përgjithësi si dhe për Inputet 1 dhe Inputet 2 (2010 = 100).

Ndryshimet e indeksit të tremujorit të tretë në vitin 2017 krahasuar me vitin 2016 (ndryshimi në %)

Indeksi i tremujorit të tretë të inputeve në vitin 2017 ka rënie për (-2.8 %) për **Input 1** krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2016. Indeksi për **Input 2** ka rritje për (0.9 %) krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2016. Indeksi i inputit të përgjithshëm (**Input 1 + Input 2**) ka rënie për (- 1.2 %) krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2016.

Grafiku 1: Indeksi TM3 i çmimeve të inputeve 2010 – 2017, (2010 = 100)



Indeksi i çmimeve të inputeve bujqësore TM3 2010-2017 (2010=100)**Tabela 1: Indeksi i Çmimeve të inputeve bujqësore TM3 2010-2017, (2010=100)****Input 1 (Mallrat dhe shërbimet aktualisht të konsumuara në bujqësi)**

Kodi i IÇPB	Përshkrimi	Pesha		TM3 2010	TM3 2011	TM3 2012	TM3 2013	TM3 2014	TM3 2015	TM3 2016	TM3 2017
		%	1000 Euro								
200000	MALLRAT DHE SHËRBIMET AKTUALISHT TË KONSUMUARA NË BUJQËSI (INPUT 1)	587	110 854	99,5	111,6	119,0	121,8	120,2	121,2	112,5	109,4
201000	FARËRAT DHE MATERIALI MBËLTUES	66	12 491	99,8	111,6	105,6	105,4	118,2	187,7	120,2	108,8
202000	ENERGJI; LUBRIFIKANT	94	17 699	101,3	113,7	124,7	117,1	115,8	102,1	95,9	102,2
202100	Energjia elektrike	9	1 757	83,7	85,0	107,5	107,5	116,9	120,1	119,0	146,3
202300	Lëndë djegëse	80	15 145	103,4	117,8	127,4	119,0	116,2	99,6	93,3	97,6
202400	Lubrifikant	4	797	99,0	98,8	111,7	103,2	104,9	108,7	94,3	93,4
203000	PLEHRAT DHE PËRMIRËSUESIT E TOKËS	130	24 512	98,9	124,1	142,1	147,1	135,9	131,2	127,8	116,0
203100	Plehrat e thjesht	53	10 050	98,4	126,4	153,5	155,8	143,2	135,0	126,9	118,3
203200	Plehrat e përbëra	77	14 462	99,3	122,5	134,1	141,1	130,8	128,6	128,5	114,3
204000	PRODUKTET PËR MBROJTJEN E BIMËVE DHE PESTICIDET	21	4 045	100,4	97,7	99,4	145,8	157,9	105,3	112,9	112,7
205000	SHPENZIMET VETERINARE	65	12 178	99,2	107,1	104,9	107,0	104,8	102,1	100,9	99,0
206000	LËNDË PËR USHQIM KAFSHËSH	63	11 959	96,4	116,1	135,5	133,3	130,4	111,9	115,7	113,5
206100	Lëndë të thjeshta ushqimi	57	10 763	95,5	116,6	138,3	135,1	131,1	114,5	118,7	115,5
206200	Lëndë të përbëra ushqimi	6	1 196	104,9	111,5	110,0	117,9	124,0	89,1	88,6	95,4
207000	MIRËMBAJTJA E MATERIALEVE	36	6 711	100,0	99,9	100,4	100,2	100,2	99,2	99,3	98,5
208000	MIRËMBAJTJA E NDËRTESAVE	6	1 084	100,1	100,8	101,9	100,0	100,8	100,0	97,8	98,4
209000	MALLRAT DHE SHËRBIMET TJERA	107	20 175	99,9	101,8	104,0	110,8	109,9	113,5	113,7	115,3

Input 2 (Mallrat dhe shërbimet që kontribuojnë në investimet bujqësore)

210000	MALLRAT DHE SHËRBIMET QË KONTRIBUJNË NË INVESTIMET BUJQËSORE (INPUT 2)	413	77 920	99,8	101,2	101,6	102,9	104,9	116,1	116,1	117,2
211210	TRAKTOR	187	35 250	99,6	101,3	101,3	104,4	107,4	131,0	132,9	132,9
211290	TJERA	226	42 670	99,9	101,2	101,8	101,8	102,9	103,7	102,3	104,2

Inputi i përgjithshëm (Input 1 + Input 2)

220000	INPUTI I PËRGJITHSHËM (INPUT1 + INPUT 2)	1 000	188 774	99,6	107,3	111,8	114,0	113,9	119,1	114,0	112,6
---------------	---	--------------	----------------	-------------	--------------	--------------	--------------	--------------	--------------	--------------	--------------

Indeksi mujor i çmimeve të inputeve bujqësore korrik – shtator 2017, (2010=100)

Tabela 2: Indeksi mujor i çmimeve të inputeve bujqësore korrik – shtator 2017 , (2010 = 100)
Input 1 (Mallrat dhe shërbimet aktualisht të konsumuara në bujqësi)

Kodi i IÇPB	Përshkrimi	Pesha		2017		
		%	1000 Euro	Kor	Gus	Sht
200000	MALLRAT DHE SHËRBIMET AKTUALISHT TË KONSUMUARA NË BUJQËSI (INPUT 1)	587	110 854	109,1	109,2	109,8
201000	FARËRAT DHE MATERIALI MBËLTUES	66	12 491	109,1	108,6	108,8
202000	ENERGJI; LUBRIFIKANT	94	17 699	101,4	102,8	102,6
202100	Energjia elektrike	9	1 757	146,3	146,3	146,3
202300	Lëndë djegëse	80	15 145	96,6	98,2	98,0
202400	Lubrifikant	4	797	93,4	93,4	93,4
203000	PLEHRAT DHE PËRMIRËSUESIT E TOKËS	130	24 512	116,0	116,0	116,0
203100	Plehrat e thjesht	53	10 050	118,3	118,3	118,3
203200	Plehrat e përbëra	77	14 462	114,3	114,3	114,3
204000	PRODUKTET PËR MBROJTJEN E BIMËVE DHE PESTICIDET	21	4 045	114,5	112,1	111,6
205000	SHPENZIMET VETERINARE	65	12 178	99,0	99,0	99,0
206000	LËNDË PËR USHQIM KAFSHËSH	63	11 959	111,9	111,4	117,3
206100	Lëndë të thjeshta ushqimi	57	10 763	113,7	113,2	119,7
206200	Lëndë të përbëra ushqimi	6	1 196	95,7	95,2	95,2
207000	MIRËMBAJTJA E MATERIALEVE	36	6 711	98,6	98,6	98,4
208000	MIRËMBAJTJA E NDËRTESAVE	6	1 084	98,5	98,4	98,4
209000	MALLRAT DHE SHËRBIMET TJERA	107	20 175	115,2	115,2	115,4

Input 2 (Mallrat dhe shërbimet që kontribuojnë në investimet bujqësore)

210000	MALLRAT DHE SHËRBIMET QË KONTRIBUOJNË NË INVESTIMET BUJQËSORE (INPUT 2)	413	77 920	115,9	115,8	115,7
211210	TRAKTOR	187	35 250	133,0	132,8	132,8
211290	TJERA	226	42 670	101,8	101,7	101,5

Inputi i përgjithshëm (Input 1 + Input 2)

220000	INPUTI I PËRGJITHSHËM (INPUT1 + INPUT 2)	1 000	188 774	111,9	111,9	112,2
---------------	---	--------------	----------------	--------------	--------------	--------------

Ndryshimi mujor i indeksit të çmimeve të inputeve bujqësore korrik – shtator 2017/2016 (2010=100)**Tabela 3: Ndryshimi mujor i indeksit të çmimeve të inputeve bujqësore korrik – shtator 2017/2016 (2010= 100)****Input 1 (Mallrat dhe shërbimet aktualisht të konsumuara në bujqësi)**

Kodi i IÇPB	Përshkrimi	Pesha		Kor 17/ Kor 16 Ndrysh. në %	Gus 17/Gus 16 Ndrysh. në %	Sht 17/Sht 16 Ndrysh në %
		%	1000 Euro			
200000	MALLRAT DHE SHËRBIMET AKTUALISHT TË KONSUMUARA NË BUJQËSI (INPUT 1)	587	110 854	-3,1	-3,0	-2,2
201000	FARËRAT DHE MATERIALI MBËLTUES	66	12 491	-8,8	-9,7	-9,7
202000	ENERGJI; LUBRIFIKANT	94	17 699	5,7	7,5	6,7
202100	Energjia elektrike	9	1 757	23,0	23,0	23,0
202300	Lëndë djegëse	80	15 145	3,6	5,6	4,7
202400	Lubrifikant	4	797	-1,7	-0,5	-0,5
203000	PLEHRAT DHE PËRMIRËSUESIT E TOKËS	130	24 512	-9,1	-9,3	-9,3
203100	Plehrat e thjesht	53	10 050	-6,4	-6,9	-6,9
203200	Plehrat e përbëra	77	14 462	-11,0	-11,0	-11,0
204000	PRODUKTET PËR MBROJTJEN E BIMËVE DHE PESTICIDET	21	4 045	1,6	-0,5	-1,5
205000	SHPENZIMET VETERINARE	65	12 178	-2,4	-1,7	-1,7
206000	LËNDË PËR USHQIM KAFSHËSH	63	11 959	-4,8	-4,0	3,3
206100	Lëndë të thjeshta ushqimi	57	10 763	-5,8	-4,9	3,0
206200	Lëndë të përbëra ushqimi	6	1 196	7,8	7,3	7,9
207000	MIRËMBAJTJA E MATERIALEVE	36	6 711	-1,0	-1,0	-0,4
208000	MIRËMBAJTJA E NDËRTESAVE	6	1 084	0,8	0,7	0,2
209000	MALLRAT DHE SHËRBIMET TJERA	107	20 175	1,4	1,2	1,5

Input 2 (Mallrat dhe shërbimet që kontribuojnë në investimet bujqësore)

210000	MALLRAT DHE SHËRBIMET QË KONTRIBUOJNË NË INVESTIMET BUJQËSORE (INPUT 2)	413	77 920	0,9	0,8	0,7
211210	TRAKTOR	187	35 250	0,1	-0,1	0,0
211290	TJERA	226	42 670	1,9	1,8	1,4

Inputi i përgjithshëm (Input 1 + Input 2)

220000	INPUTI I PËRGJITHSHËM (INPUT1 + INPUT 2)	1 000	188 774	-1,4	-1,4	-1,0
--------	---	--------------	----------------	-------------	-------------	-------------

Metodologjia

Çmimet dhe indekset e çmimeve në këtë publikim janë kalkuluar sipas standardeve për statistikat e çmimeve të Bashkimit Evropian. Projekti për kalkulimin e këtyre çmimeve dhe indekseve të çmimeve është realizuar brenda projektit për “Përmirësimin e statistikave agromonetare” në bashkëpunim me Statistikat Suedeze dhe me mbështetjen financiare nga SIDA (Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar).

Çmimet janë grumbulluar në shtatë regjione: Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Gjakovë, Prizren, Ferizaj dhe Gjilan. Çmimet janë grumbulluar çdo muaj rreth datës 15. Që nga fillimi numri i artikujve për të cilët janë grumbulluar çmimet është rritur hap pas hapi.

Qëllimi i Indeksit të çmimit të inputeve bujqësore është përcjellja e çmimeve të blerjes të mjeteve për prodhim bujqësor. Sipas definicionit, indeksi nuk i mbulon faktorët e prodhimit. Rrjedhimisht, rrogat dhe kostoja e rrogave, qiraja, pagesa e kamatës, blerja e tokës dhe kafshët si asete fikse nuk janë pjesë e fushë-vëzhgimit.

Për të krahasuar indeksin e BE-së të paraqitur në këtë publikim me shtetet tjera, rekomandohet faja elektronike e Eurostat-it (<http://epp.eurostat.ec.europa.eu/portal/page/portal/eurostat/home>).

Peshat për kalkulimin e indekseve të agreguara kryesisht janë bazuar në Llogaritjet ekonomike bujqësore 2010, që është viti bazë në indeks (2005=100). Këto peshat janë fikse përderisa baza e indeksit është viti 2010. Indeksi është indeks i çmimit dhe kalkulohet bazuar në formulën e *Laspeyres*.

Llogaritja e indeksit elementar të çmimit

Llogaritja e indekseve elementare është bërë në përgjithësi duke përdorur formulat në vijim, me çmim mesatar aritmetik të papeshuar.

$$R_i^t = \frac{\frac{1}{n} \sum P_{ij}^t}{\frac{1}{n} \sum P_{ij}^o} \cdot 100$$

R_i^t – Indeksi elementar për muajin t dhe prodhimin i

P – Çmimi i grumbulluar

i – Prodhimi i

j – Çmimi j i regjistruar për prodhimin (në përgjithësi çmimi për regjionin)

t – Muaji i vëzhguar

0 – Muaji bazë

Llogaritja e indeksit të agreguar të çmimit

Llogaritja e indeksit të agreguar për totalin e inputeve ose nëngrupeve të indeksit të inputeve është bërë duke shfrytëzuar formulën në vijim.

$$I^t = \sum \left(R_i^t \cdot \frac{w_i^0}{\sum w_i^0} \right)$$

I^t - Indeksi i agreguar për periudhën t

w_i^0 - Faktori peshues në periudhën bazë për prodhimin i

i - Prodhimi i

t - Muaji i vëzhguar

0 - Muaji bazë

Pyetëtori

DEFINICIONI -Përcaktimi i caktut (artikujve- vareteteve)

Numri i artikullit	Emri i artikullit			Sasia	Njësia
	Grumbulluesi i çmimit			Vendi i grumbullimit / Ndërmarrja	
Data					
Çmimi					

Shënimet e anketuesve

- Përshkrimi hollësishëm i artikullit (varietetit) specifik të zgjedhur për monitorim të çmimit
- Ndryshimet në përshkrimin e hollësishëm, data e ndryshimeve
- Trajtimi i ndryshimit të kualitetit kur përshkrimi është ndryshuar (informacionet e vrojtimit të dyfishta të çmimit, plotësuese dhe vlerësimi i ndryshimit të kualitetit)

Agjencia e statistikave të Kosovës

përshkrim i shkurtër

Agjencia e statistikave të Kosovës është institucion profesional i cili merret me grumbullimin, përpunimin dhe publikimin e të dhënave zyrtare të statistikave. Si i tillë vepron që nga viti 1948 i cili ka kaluar nëpër disa faza historike, i strukturuar sipas rregullimit shtetëror të asaj kohe.

Më 2 Gusht 1999, Agjencioni ka rifilluar punën e vet profesionale (pas 9 viteve të ndërprerjes të të gjitha serive statistikore në dëm të interesit të Kosovës), si institucion i pavarur në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike. Që nga data 12.12.2011 ky Agjencion vepron në kuadër të Kryeministrisë së Kosovës. Agjencioni financohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës por edhe nga donatorët për projekte të veçanta dhe për ndihmë teknike profesionale.

Agjencia e Statistikave të Kosovës vepron sipas Ligjit Nr. 04/L-036 i cili ka hyrë në fuqi më 12.12.2011. Plani zhvillimor strategjik 2009-2013 është në implementim afatmesëm për zhvillimin e sistemit statistikor në korrelacion me Statistikat e Bashkësisë Evropiane (EUROSTAT-it).

Agjencia e statistikave të Kosovës ka këtë *strukture organizative: Departamentet prodhuese; (Departamenti i statistikave ekonomike dhe llogarive kombëtare, Departamenti i statistikave të bujqësisë dhe mjedisit, dhe Departamenti i statistikave sociale. Departamentet mbështetëse; (Departamenti i metodologjisë dhe teknologjisë informative, Departamenti për politika, planifikim, koordinim dhe komunikim, Departamentii i Regjistrimit dhe Anketimit si dhe Departamenti i administratës. Ne kuadër të Agjencionit veprojnë edhe; Zyrat Rajonale; Gjakovë, Gjiilan, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Prishtinë, dhe Ferizaj*

Numri i të punësuarve dhe buxheti akoma janë të limituar. Të punësuar janë gjithsej 143 punëtorë, prej tyre, 98 (68,5%) në seli të Agjencionit, gjersa në Zyrat Rajonale, 45 (31,5%), Agjencioni ka ketë strukture kualifikuese, 61,7% me shkollim universitar, 15,4 me shkollim të lartë, ndërsa 17,5% me shkollim të mesëm.

Kemi bashkëpunim profesional dhe teknik me të gjitha Ministrinë e Qeverisë së Kosovës, sidomos me Ministrin e Ekonomisë dhe Financave, Bankën Qendrore të Kosovës, me institucionet ndërkombëtare, EUROSTAT-in, Fondin Monetar Ndërkombëtare, Bankën Botërore, SIDA e Suedisë, DFID, UNFPA, UNDP, UNICEF, dhe me statistikatat e shteteve në rajon.

Agjencia e Statistikave të Kosovës mbulon gati krejtësisht territorin e Republikës së Kosovës, duke u organizuar në strukturimin e qarqeve statistikore dhe njësisve raportuese si njësi bazë dhe të vetme në shkallë vendi nga të cilat merr informatat e dorës së parë. Te gjitha anketat e zhvilluara në terren përdorin shtrirjen e mostrës në këto qarqe statistikore por edhe metodologjinë sipas rekomandimeve ndërkombëtare. Gjatë grumbullimit të të dhënave statistikore dhe raporteve nga njësitë raportuese angazhohen; profesionistë, teknikë, administratorë, civilë të zyrave të vendit, regjistruar terreni nga Zyrat Rajonale etj.

Në vitin 2011 është realizuar me sukses projekti i Regjistrimit të Popullsisë Ekonomive Familjar dhe Banesave, ndërsa në vitin 2014 është realizuar po ashtu me sukses Rregjistrimi i Bujqësisë . Rezultatet e fituara nga këto regjistrime do të kenë një rol të rëndësishëm për hartimin e Politikave zhvillimore.

Misioni i Agjencionit; të përmbush nevojat e shfrytëzuesve me të dhëna statistikore kualitative, objektive, në kohë dhe hapësirë në mënyrë që shfrytëzuesit të kenë bazë të besueshme që të bëjnë analiza të rregullta në interes të planifikimit dhe zhvillimit gjatë hartimit të projekteve në shkallë vendbanimi, komune dhe vendi. Të përkrah institucionet qeveritare, institutet, shkencën, akademinë , bizneset si dhe hulumtuesit e pavarur etj. në mënyrë që t'u sigurojë informata të duhura për vendim-marrësit si dhe përdoruesit tjerë në Kosovë.

- o **Adresa: AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS,**
Rr. "Zenel Salihu", nr. 4, 10000 Prishtinë
- o **Telefoni:** +381 (0) 38 200 31 129
Kryeshafi Ekzekutiv: +381 (0) 38 200 31 112
- o **Fax::** +381 (0) 38 235 033
- o **E-mail:** infoask@rks-qov.net
- o **Ueb-faqe:** <http://ask.rks-qov.net>